



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 34/11
Prishtinë, më 09.11.2011, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj dhe Duda Balje.

Mungoi: Naser Osmani dhe Muhamet Mustafa.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Dardan Sejdiu-Lëvizja Vetëvendosje, Naim Hajdari-EULEX, Lejla Selimi-OSCE, Teki Shala-Kuvendi i Kosovës, Isuf Zejna-KDI, Juergen Schatz, Alexander Beetz, Rejhane Zylfijaj, Njomza Ilazi dhe Ramadan Islami-GIZ.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli, Aurora Ademi dhe Njomza Halilaj (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 25.10.2011 dhe 01.11.2011;**
- 3. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011**
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
- 4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012**
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave;
- 5. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për shpenzimet e Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2011**
I ftuar: Ismet Krasniqi, Sekretar i Kuvendit;
- 6. Shqyrtimi i Rregullores së Punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa;**
- 7. Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, hapi mbledhjen dhe propozoi rendin e ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura të komisionit, datë 25.10.2011 dhe 01.11.2011

Kryetarja, theksoi se ka disa vërejtje rreth procesverbaleve, të cilat do ti dërgohen stafit për përisimin.

Albana Fetoshi, kërkoi që në procesverbalin e datës 01.11.2011 të përmirësohet komenti i saj lidhur me draft-rregulloren pasi që ajo ka thënë që vërejtjet do t'i paraqesë në mbledhjen e radhës, pasi që në këtë mbledhje nuk po shqyrtohet draft-rregullorja.

Procesverbalet miratohen me këto plotësime.

3. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2011

Kryetarja, paraprakisht u përkujtoi anëtarëve të komisionit që në mbledhjen e mbajtur më 11.05.2011 komisioni njëzëri kishte vendosur që raportet tre mujore, të mos i shqyrtojë, përveç nëse ka interes të caktuar nga Komisioni dhe ato të shkojnë vetëm për njoftim në Kuvend.

Bedri Hamza, si veçori kualitative të këtij raporti theksoi performancën e fuqishme të të hyrave për Buxhetin e Republikës së Kosovës, si dhe ngritjen substanciale në ekzekutimin e buxhetit, sidomos në kategorinë e investimeve kapitale. Ministri njoftoi se të hyrat e përgjithshme, duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve si dhe fondet në mirëbesim janë 933.1 milion € që paraqesin 74% të pranimeve të përgjithshme vjetore të planifikuara dhe një rritje prej 4% në krahasim me vitin paraprak dhe më pas prezantoi realizimin e të hyrave nga kategoritë dhe institucionet e caktuara, duke prezantuar të hyrat e realizuar në shuma monetare dhe në përqindje, duke krahasuar me planin vjetor dhe krahasimet me realizimin e të hyrave me vitin paraprak, në periudhën e njëjtë raportuese. Sa i përket shpenzimeve, njoftoi se pagesat gjatë këtij nëntë mujori duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve janë 902.7 milion € ose 60% të planit vjetor. Në kuadër të tyre kategoria pagat dhe rrogat është në vlerë prej 249.7 milion € ose 64% e planit vjetor që paraqet një rritje prej 12% në krahasim me vitin paraprak, mirëpo këtu nuk përfshihet paga e muajit Shtator e cila është paguar më 1 Tetor. Në vazhdim prezantoi shpenzimet sipas kategorive ekonomike duke prezantuar të hyrat e realizuar në shuma monetare dhe në përqindje, duke krahasuar me planin vjetor dhe krahasimet me realizimin e të hyrave me vitin paraprak, në periudhën e njëjtë raportuese. Financimet tjera janë në vlerë prej 35.2 milion € ose 63% e planit vjetor dhe këtu përfshihet huaja e KEK-ut prej 24.1 milion € dhe pagesa e borxhit të jashtëm në vlerë prej 11 milion €. Gjendja fillestare e fondeve të Buxhetit të Republikës së Kosovës në vitin 2011 ka qenë 290.8 milion €, ndërsa deri 30 Shtator 2011 bilanci i fondeve është 317.6 milion €, dhe si rezultat i mbledhjes më të madhe të të hyrave se sa i shpenzimeve, paraqitet, një rritje e bilancit të fondeve në vlerë prej 27.8 milion €.

Kryetarja, kërkoi sqarime për financimin e buxhetit për vitin 2011 pasi që në Raportin e Progresit shënon që ky financim po përballet me rreziqe të konsiderueshme.

Bedri Hamza, theksoi se sa i përket vitit 2011, stabiliteti makroekonomik nuk është në pikëpyetje, pasi që performanca e të hyrave është jashtëzakonisht e mirë dhe do të ketë një tejkalim të planit të të hyrave dhe një ekzekutim të buxhetit mbi 90%. Pavarësisht mos finalizimit të procesit të privatizimit të PTK-së, do të ketë një bilanc bankar pozitiv mbi 120 milion € në fund të vitit 2011, i cili do të mundësojë kryerjen e obligimeve për pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, subvencionet dhe transferet dhe investimet kapitale.

Hykmete Bajrami, theksoi që me kërkesën e FMN-së Qeveria është dashur ta ndajë një rezervë prej 60 milion €, ku 37 milion € janë shkurtuar në shpenzimeve kapitale, 10 milion € janë kursyer nga mos pagesa e pagave në mënyrë retroaktive dhe 15 milion € janë kursyer nga mos dhënia e kredisë KEK-ut. Sipas Raportit të Progresit, Qeveria ka rreth 32 milion € obligime të papaguara. Natyrisht që viti mund të mbyllet me një bilanc bankar pozitiv, kur janë bërë të gjitha këto shkurtime duke mos u paguar bizneset që kanë kryer punë për Qeverinë dhe falë asaj që Qeveria ka trashëguar një bilanc bankar pozitiv në fillim të vitit 2011 në vlerë prej 244 milion €. Lidhur me planin e shpenzimeve theksoi që ato të dhëna që i sqaroi ministri në përqindje të realizimit të planit vjetor nuk janë të paraqitura në materialin që u është dorëzuar anëtarëve të komisionit, por janë paraqitur vetëm në krahasim me vitin paraprak dhe kjo e ka vështirësuar analizën e këtij raporti, pasi që më e nevojshme është të bëhet krahasimi me atë se sa është planifikuar e jo me vitin paraprak. Vërejtjet e theksuara ishin te shënimi 12 Pagat dhe Rrogat ku me rritjen e pagave sipas vendimit të Qeverisë fondi i përgjithshëm i pagave për vitin 2011 është rritur për 23%, ndërsa këtu del që në krahasim me vitin 2011 për periudhën nëntë mujore janë shpenzuar vetëm 12% dhe kjo u arsyetua me atë se pagat e Shtatorit janë paguar në Tetor dhe ndoshta me këtë jeni munduar t'ia mbushni mendjen FMN-së që kemi kesh në bilancin bankar si dhe mos pagesa e shumë retroaktive. Te shënimi 13, pavarësisht vendimit të Qeverisë për disiplinimin në shfrytëzimin e veturave zyrtare dhe në uljen e shpenzimeve, kemi një rritje prej 39% të derivateve. Kërkoj sqarim për përfshirjen e kabllit optik në kuadër të shërbimeve të telekomunikimit, pasi që kabli optik nuk është material shpenzues që të përfshihet në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Te shënimi 16 Investimet kapitale del që ka pasur rritje prej 39%, përderisa buxheti është rritur për 25.7%, a ka mbetur të paguhet më shumë në tremujorin e fundit apo qëndron ndonjë arsye tjetër? Te shënimi 15 Subvencionet dhe Transferet, buxheti për të cilat është rritur për 7.5%, ndërsa kemi 0.5% shpenzime më pak, kjo është ndoshta për shkak se rritja e pensioneve është buxhetuar në vitin 2011 dhe Qeveria nuk e ka sjellur ligjin dhe nuk janë paguar pensionet me rritje. Kërkoj sqarime te aneksi 3 të dhënat e punësimit ku del që numri i punëtorëve për organizatat buxhetore është 35.000, sipas Ligjit të Buxhetit ky numër është 35.114, kurse numri aktual është 32.957 që del diku 2.000 punëtorë më pak. Gjithashtu edhe punëtorët e Universitetit sipas ligjit janë 2.142, ndërsa aktual janë 1.521, ku qëndron arsyeja?

Bedri Hamza, theksoi se është e pakontestueshme që ka pasur një performancë jashtëzakonisht të mirë të të hyrave dhe është vlerësuar rritja e të hyrave në doganë prej 16% dhe në ATK 22 %. Sa i përket 60 milion € të kërkuara nga FMN-ja theksoi që kemi qenë më se të kujdesshëm që të mos rrezikohet asnjë projekt, i cili është në zhvillim dhe këto para mund të merren vetëm nga kategoria Mallra dhe Shërbime, pasi që për këtë kategori janë në dispozicion 170 milion €, ndërsa janë shpenzuar vetëm 110 milion €. Lidhur me investimet kapitale ka pasur teprica në projekte të caktuara ose projekte që ende nuk kanë filluar. Vonesat në pagesa nuk janë 32 milion € dhe raporti i fundit, i cili do të del nga FMN-ja do të paraqes saktësisht 2 milion € vonesë në pagesa në totalin e Buxhetit të Republikës së Kosovës. Të dhënat për krahasimet në raport me planifikimin janë të paraqitura në faqen 4 të raportit. Sa i përket çështjes së pagave nuk ka pasur vonesa dhe pagat gjithmonë janë ekzekutuar ose para përfundimit të muajit, ose në ditën e parë të muajit dhe realisht me ligj kërkohet që të bëhet në ditën e parë të muajit, mirëpo në rast të festave pagat janë ekzekutuar edhe para kohe dhe absolutisht nuk ka qenë qëllimi që të bindet FMN-ja se kemi kesh në bilancin bankar. Lidhur me

derivatat theksoi që Ministria e Financave nuk është avokat i asnjë organizate buxhetore dhe nëse dikush e ka bërë ekzekutimin e buxhetit në mënyrë të gabuar, atëherë është auditori i cili i kryen këto punë dhe organet kompetente, mirëpo kjo mund të jetë edhe si rezultat i rritjes së çmimit të derivateve në vitin 2011. Lidhur me shpenzimet e telefonisë theksoi se çdo gjë që lidhet me telefoninë është e përfshirë në këtë kategori për shkak të kodit. Sa i përket subvencioneve dhe transfereve, Ministria e Financave e ka ndarë koston e vlerësuar për Ligjin e Pensioneve dhe është pjesë e tabelave buxhetore. Ministria sponzoruese është Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe ky ligj është pjesë edhe e marrëveshjes me FMN-në. Sa i përket numrit të të punësuarve, sqaroi se aktualisht janë më pak të punësuar se sa që janë paraparë me Ligjin e Buxhetit, si rezultat i mos plotësimit të numrit të lejuar në Policinë e Kosovës dhe në FSK, ndërsa në Universitet ka edhe bashkëpunëtorë të jashtëm. Sa i përket çështjes së dallimit të të hyrave, sqaroi se në vitin e kaluar deri më datën 30 Shtator dividendi ka qenë 85 milion €, ndërsa në këtë vit është 60 milion € si dhe fondet nga FMN-ja kanë qenë rreth 22 milion € pjesa e parë dhe 30 milion € kanë qenë nga Komisioni Evropian.

Kryetarja, kërkoi informata më të detalizuara lidhur me ligjet të cilat janë pjesë e marrëveshjes me FMN-në.

Bedri Hamza, sqaroi se ky dokument është publik në web faqe ku janë të listuara ligjet të cilat janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Bëhet fjalë për: Ligji i Pensioneve, Ligji për Kategoritë e Dalura nga Lufta, dy ligjet e Shëndetësisë, Ligji për Pensionimin e Pjesëtarëve të TMK-së që shërbejnë në FSK si dhe do të jetë edhe Ligji për Trustin e Pensioneve të Kosovës.

Sali Asllanaj, shprehu vërejtje për privatizimin e PTK-së duke kërkuar që privatizimi të bëhet në mënyrë më të qetë dhe me një planifikim afatgjatë strategjik si dhe me një çmim më të volitshëm.

Hasime Krasniqi, shprehu komplimente për përgatitjen e raportit në mënyrë të detalizuara duke u bazuar në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Komisioni me pesë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi dhe Hasime Krasniqi), tri kundër (Albana Fetoshi, Hykmete Bajrami dhe Sali Asllanaj) dhe një abstenim (Xhevdet Neziraj) nxorri këtë:

REKOMANDIM

Raporti nëntëmujor i Buxhetit të Republikës së Kosovës u dërgohet për informim deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012

Kryetarja, lidhur me Projektbuxhetin e vitit 2012 theksoi që materiali teknikisht është i përgatitur mirë, duke përfshirë pjesën tekstuale, pjesën tabelare si dhe treguesit makroekonomikë, të cilat e mundësojnë një analizë të duhur. Ky projektbuxhet bazohet në prioritetet e Qeverisë siç janë zhvillimi ekonomik, sundimi i ligjit, përmirësimi i administratës publike dhe mirëqenies sociale si dhe paraqet një rritje të të hyrave prej 4% dhe rritje të shpenzimeve prej 7.6% në krahasim me vitin 2011.

Bedri Hamza, theksoi që Projektbuxheti i vitit 2012 është në harmoni të plotë me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe është i bazuar në prioritetet e Qeverisë, në veçanti në ruajtjen e qëndrueshmërisë makrofiskale dhe mbi të gjitha është i harmonizuar me FMN-në. Deficiti buxhetor i planifikuar është 3.2%, i cili është brenda parametrave të lejuar të BE-së. Sa i

përket ecurive që priten të ndodhin në vitin 2012, sidomos në Eurozonë ato mund të ndikojnë në remitenca, në eksporte dhe në çmimin e derivateve. **Të hyrat** në total janë 1 miliardë e 361 milion €, prej të cilave 860 milion € janë të planifikuara nga Doganat, 285 milion € nga ATK-ja, 35 milion € nga dividendi i paraparë nga PTK-ja dhe pjesa tjetër paraqet të hyrat vetanake të nivelit qendror dhe atij komunal, ndërsa burimet e 13 milion € që janë të planifikuara si të hyra do të specifikohen në mes të dy leximeve dhe në marrëveshje me FMN-në. Ka rreziqe pozitive, pasi që nuk janë paraparë mjetet e procesit të likuidimit dhe nuk janë paraqitur në tabelat buxhetore, për shkak se Qeveria ka dashur që njëherë të vijnë ato mjete në Buxhetin e Kosovës dhe pastaj të propozojë ndarjen e tyre dhe Kuvendi të vendosë për shpërndarjen e tyre. Buxheti është i ndërtuar në të hyrat e rregullta, në bartjen nga viti 2011 në vitin 2012, në të hyrat e njëhershme në vlerë prej 300 milion €. Gjithashtu janë të planifikuara grantet nga Banka Botërore dhe 92 milion € nga FMN-ja. Lidhur me privatizimin e PTK-së, sqaroi se me FMN-në janë diskutuar të dyja rastet, edhe nëse privatizohet, edhe nëse nuk privatizohet dhe siguroi që kjo nuk do të rrezikojë qëndrueshmërinë makrofiskale. Shpërndarja e granteve nëpër komuna është bërë sipas formulës së granteve. Te niveli qendror kategoria e pagave është rritur si rezultat i plotësimit të numrit të punëtorëve, të cilët pritet t'i plotësojnë kapacitetet në vitin e ardhshëm si dhe krijimi i institucioneve të reja sipas ligjeve. Kategoria mallra dhe shërbime është në vlerë prej 198 milion €, ku përfshihet edhe fondi për organizimin e zgjedhjeve presidenciale. Te kategoria e subvencioneve dhe transfereve, përveç shpenzimeve që janë prezente në vitin 2011, parashihet edhe kostoja e Ligjit për Pensionet, Ligjit për Pensionet e Pjesëtarëve të TMK-së në FSK, Ligjit për Kategoritë e Dalura nga Lufta dhe rritja natyrale e pensionistëve. Sa i përket sektorit të energjisë janë 13 milion € subvencione për KEK-un që janë të ndara në Ministrinë për Zhvillim Ekonomik, ndërsa 7 milion € janë për të njëjtin qëllim në Ministrinë e Financave si kontigjencë, plus 4.5 milion € që janë për raste sociale dhe 15 milion € është pjesa e kredisë për KEK-un që bartet në vitin 2012. Subvencionet për ndërmarrjet publike janë zvogëluar, ndërsa kemi marrëveshje me KfW-në që 3 milion € të subvencionojmë ngrohtoren e qytetit të Prishtinës, me qëllim të fitimit të grantit kombinim me kredi për projektin e kogjenerimit për ngrohtoren e Prishtinës. Investimet kapitale për herë të parë e kalojnë vlerën prej 616 milion €, prej të cilave 296 milion € janë për autostradën Morinë-Merdarë, 56 milion € janë në Ministrinë e Ambientit për shpronësim dhe 240 milion € janë për ndërtim dhe pjesa tjetër prej 320 milion € janë për projektet tjera kapitale. Gjithashtu, parashihet që deri në fund të vitit 2012 do të jenë në funksion mbi 20 shkolla të reja. Rritjen më të madhe e ka Ministria e Bujqësisë rreth 56% si dhe 20 milion € përfitime nga Banka Botërore. Ministria e Punëve të Brendshme ka një rritje prej 7% ndërsa Ministria e Shëndetësisë ka rritje prej 12%. Në përgjithësi **totali i shpenzimeve** është 1 miliardë e 520 milion € duke shtuar edhe pjesën për servisimin e borxhit prej 13 milion €.

Sali Asllanaj, nuk e përkrahu këtë projeksion buxhetor, për shkak se ka shumë pikëpyetje për burimet financiare e këtij projektbuxheti, përderisa shpenzimet janë gjithmonë të garantuara. Ka nevojë për burime të përhershme të financimit dhe mos të llogaritet privatizimi i PTK-së si dhe po bëhet politikë në projekte dhe po ekziston një dis-harmoni zhvillimore.

Albana Fetoshi, pyeti se a është versioni përfundimtar i këtij Projektbuxheti në web faqe? Veçoi dy elemente kyçe që kanë të bëjnë me këtë Projektbuxhet: mënyra se si po ndërtohet dhe financohet buxheti dhe mënyra se si po shpenzohen ato para. Ky nuk është një buxhet zhvillimor, por është buxhet shpenzues dhe gjysma e mjeteve të ndara për investime kapitale shkojnë për ndërtimin e autostradës dhe pjesa tjetër për projekte që përcillen nga 2010. Shpenzimet kapitale nuk janë konsistente me shpenzimet në mallra dhe shërbime, pasi që do të kemi ndërtime të shkollave pa arsimtarë, të spitaleve pa mjekë dhe të rrugëve pa mirëmbajtje. Nuk ka përmirësime në ambientin e biznesit, pasi që Kosova prapë mbetet në vendin e njëjtë si në vitin e kaluar si një vend i pa sigurt për të zhvilluar biznes. Rritja për paga dhe mëditja kryesisht është e lidhur me krijimin e ministrive të

reja si dhe rritja e pagave nuk është në vijë të njëjtë me inflacionin. Gjithashtu edhe rritja në mallra dhe shërbime është 5.8%, ndërsa inflacioni është rreth 7%. Sa i përket menaxhimit të Buxhetit të Republikës së Kosovës, mund t'i referohemi edhe Raportit të Progresit, i cili potencon faktin që planifikimi fiskal në vitin 2011 është dëmtuar dhe e njëjta mënyrë e planifikimit vazhdon tutje. Projektbuxheti për vitin 2012, paraqet numra që shprehin më tepër dëshira e jo gjendjen reale.

Hykmete Bajrami, shprehu vërejtje për paqëndrueshmërinë e të hyrave dhe shpërndarjen e tyre, e cila është një shpërndarje politike, duke marrë për bazë investimet që bëhen nga niveli qendror duke veçuar mjetet që i janë ndarë Prishtinës në shumë prej 575.000 € për ndërtimin e shkollave, përderisa Skenderajt i janë ndarë 1.430.000 €. Rritja e pagave, e mallrave dhe shërbimeve dhe e investimeve është nën normën e inflacionit. Investimet kapitale përfshijnë ndërtimin e autostradës, i cili është një projekt krejtësisht jo transparent. Të gjitha kritikrat që janë dhënë në vitin e kaluar vetëm sa janë theksuar më tepër, pasi që fondet nga donatorët dhe nga privatizimi i PTK-së janë zero. Në buxhet duhet të vendoset ose dividendi ose të hyrat nga shitja e PTK-së, pasi që edhe këtë vit është paraqitur dividendi në vlerë prej 35 milion € dhe të hyrat nga shitja prej 300 milion €. Kërkoj sqarim për 24 milion € të paraqitura në kuadër të 74 milion € të financimi i brendshëm, prej të cilave 50 milion € merren nga Trusti ndërsa 24 milion € është menduar që janë marrë të hyrat nga fondi i likuidimit, por Ministri e sqaroi më herët që nuk janë buxhetuar këto të hyra, atëherë pyeti se prej nga burojnë këto 24 milion €? Sa i përket investimeve kapitale që janë 616 milion €, theksoi që rritja ekonomike që po vjen nga investimet publike nuk ka efekte multiplikuese, pasi që punëtorët e angazhuar në ndërtimin e rrugëve dhe ndërtesave janë të punësuar vetëm përkohësisht. Lidhur me subvencionet dhe transferet, theksoi që buxheti për bujqësinë prapë është i vogël. Shprehu vërejtje për planin e BANSKO-s, pasi që është hequr dorë nga rritja ekonomike prej 7.8% dhe tani thuhet se rritja ekonomike është 5.3%, dhe është hequr dorë nga 3% e buxhetit të bujqësisë që është 45 milion € e që në realitet është më pak. Sa i përket ambientit të biznesit, theksoi që është problem të ndryshohet rangimi në DOING BUSINESS, duke pasur parasysh që Kosova është në vendin e parë në rajon për korrupsion.

Bedri Hamza, u përgjigj se versioni përfundimtar i këtij Projektbuxheti është para anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa. Sugjeroi që në Raportin e Progresit të vërehen edhe avantazhet, siç janë rritja e eksporteve, e investimeve, e remitencave, përmirësimi i administratës publike, niveli i ulët i borxhit të jashtëm, rritja e të hyrave nga Dogana dhe ATK-ja. Mund të ketë dallime në prioritetet, mirëpo ky buxhet është ndërtuar mbi bazën e prioritetëve që kjo Qeveri ia ka caktuar vetvetes dhe brenda disa ditëve do të bëhet publik dokumenti që tregon se FMN-ja është pajtuar me këtë buxhet dhe kjo do të dëshmojë që ky buxhet nuk mbështetet në burime të paqëndrueshme financiare. Sa i përket ndërtimit të shkollave, sqaroi se këto objekte të reja shkollore ndërtohen për t'i zëvendësuar objektet e vjetra dhe nuk paraqitet kurrfarë mungese e kuadrove. Lidhur me ambientin e biznesit theksoi që Kosova është në pozitë më të mirë se shumë vende tjera të OECD-së. Nuk duhet bërë amortizimi i pagave me inflacion dhe sipas vlerësimeve parashihet që inflacioni për periudhën e ardhshme makrofiskale të jetë rreth 2.2%. Për dividendin dhe të hyrat nga shitja sqaroi se të dyja paraqiten në buxhet, sepse dividendi është fitim i akumuluar nga ky vit dhe nga vitet e mëparshme, ndërsa privatizimi pritet të përfundojë në fund të vitit të ardhshëm. Sa i përket huamarrjes, Kosova e ka borxhin publik më të ulët në rajon dhe në Evropë prej vetëm 5.4% të GDP-së dhe është planifikuar që ky borxh të rritet në 74 milion € dhe nuk do të thotë që këto mjete do të merren vetëm nga Trusti, pasi që ka potencial edhe të bankat komerciale për të investuar në letrat me vlerë të Qeverisë. Sa i përket shpërndarjeve politike, theksoi që nuk qëndron kjo, pasi që shumica e projekteve janë në vazhdim.

Hykmete Bajrami, pyeti se si ka mundësi që dividendi prej 35 milion € të jetë fitim i akumuluar, pasi që këto mjete janë marrë në këtë vit prej PTK-së?

Albana Fetoshi, pyeti se me çfarë kamate pritet të merret borxhi i jashtëm?

Hasime Krasniqi, përgëzoi për përgatitjen e këtij projektbuxheti, duke veçuar qëndrueshmërinë bankare dhe financiare dhe është një projektbuxhet në interes të qytetarëve pa dallime partiake.

Xhevdet Neziraj, theksoi që edhe në këtë vit po hyjmë në buxhet me dy variante dhe kjo nuk është mirë. Duhet të ketë investime në drejtime tjera dhe të ketë të hyra nga zhvillimi ekonomik dhe ATK-ja e jo nga dogana.

Agim Krasniqi, sqaroi se ky është fitimi i pritur dhe i realizueshëm në gjashtëmujorin e dytë të këtij viti ose në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm. Nga bisedat me autoritetet bankare është vlerësuar që të ofrohet 25 milion €, mirëpo prapë mbetet për t'u përcaktuar varësisht nga oferta dhe kërkesa dhe nuk pati informata për normën e kamatës.

Komisioni me pesë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Duda Balje, Latif Gashi dhe Hasime Krasniqi), tri kundër (Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Albana Fetoshi) dhe një abstenim (Xhevdet Neziraj) nxorri këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kuvendin, të miratojë në parim, Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2012.

5. Shqyrtimi i Raportit nëntëmujor për shpenzimet e Kuvendit të Kosovës për vitin 2011

Ismet Krasniqi, sqaroi se ngarkesa me subvencionin për RTK-në e ka zbehur përqindjen e realizimit të buxhetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Lidhur me investimet kapitale theksoi se ka vonesa në realizimin e projekteve të parapara dhe gjithsej janë nëntëmbëdhjetë projekte kapitale, prej të cilave gjashtë kanë përfunduar, dy janë në realizim e sipër, katër janë në procedurë të vlerësimit dhe pesë tjera janë në fazën e tenderit, duke përjashtuar projektin Villa Gërmia, i cili paraqitet si problem konstant. Kërkoj që të përgatitet një rekomandim për Kryesinë e Kuvendit, për të definuar projektin Villa Gërmia, i cili është aktual në çdo projektbuxhet, mirëpo nuk po ka kurrfarë lëvizje. Njoftoi anëtarët e komisionit që Qeveria me një vendim e ka bërë shkurtimin e mallrave dhe shërbimeve për 6% të buxhetit aktual pa e njoftuar fare Kuvendin.

Hykmete Bajrami, pyeti për renovimin e zyrave për deputetët, pasi që kushtet në të cilat po punohet aktualisht janë shumë të vështira.

Xhevdet Neziraj, lidhur me projektin Villa Gërmia, theksoi që duhet të mbyllet kjo çështje njëherë e përgjithmonë, ndërsa për investimet kapitale sugjeroi që të bëhet një planifikim dhe realizim më i mirë.

Sali Asllanaj, po ashtu shprehu vërejtje për mungesën e zyreve për deputetët, pasi që kjo është më se e nevojshme për shkak të ngarkesës me punë dhe materiale.

Kryetarja, kërkoj sqarime për pajisjet tjera, të cilat në tremujorin e parë kanë qenë në vlerë prej 5.898 €, në tremujorin e dytë nuk ka pasur blerje ndërsa në tremujorin e tretë janë në vlerë prej 15.286 €. Gjithashtu nuk ka pasur mjete të ndara për subvencion, përderisa në raport po shihet që janë

shpenzuar 5.000 € dhe te stafi mbështetës politik përqindja e realizimit është 52.52%, përderisa është bërë shumë presion që të ndahen mjete për këtë kategori.

Ismet Krasniqi, sqaroi se tenderi i parë ka qenë për aneksin ku është përfshirë kulmi dhe fasada, mirëpo me mjetet që kanë qenë në dispozicion prej 500.000 € ka qenë e pamundur të realizohen këto dy aktivitete. Pastaj është hequr nga kontrata kulmi dhe fasada dhe ka mbetur vetëm ndërtimi i brendshëm i objektit dhe më datën 15 Nëntor përfundojnë punët teknike. Mirëpo, jemi në fazën e hapjes së tenderit në vlerë prej 190.000 € që ka të bëjë me mobilim dhe nëse tenderi kalon, atëherë menjëherë në ditët e para të vitit 2012 do të bëhet akomodimi i nënkryetarëve të Kuvendit, kryetarëve të komisioneve dhe shefave të grupeve parlamentare në aneks dhe zyret e liruara do t'u shpërndahen në proporcion me numrin e deputetëve në grupet parlamentare. Për stafin mbështetës politik, sqaroi se ata janë punësuar nga data 1 Korrik, përderisa mjetet kanë qenë të ndara më herët dhe këtu qëndron arsyeja që ato mjete kanë mbetur të pa shfrytëzuara.

Istret Azemi, lidhur me pajisjet tjera sqaroi se në tremujorin e tretë janë blerë disa pajisje diku rreth 15 televizione me të cilat janë pajisur zyret e komisioneve, gjithashtu janë blerë edhe pajisje për nevojat e zyrës së IT-së. Për subvencionin sqaroi se me vendim të Kryesisë së Kuvendit, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka subvencionuar KMDLNJ-në në vlerë prej 2.000 € dhe tre policët e plagosur më 25 Korrik në Mitrovicë me nga 1.000 € për secilin.

Komisioni me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj), asnjë kundër dhe një abstenim (Albana Fetoshi) nxorri këtë:

REKOMANDIM

I rekomandohet Kryesisë së Kuvendit të miratojë Raportin Shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2011.

6. Shqyrtimi i Rregullores së Punës së Komisionit për Buxhet dhe Financa

Albana Fetoshi, shprehu vërejtje për Draft-Rregulloren e Komisionit te neni 7 pika 3 që ka të bëjë me mbledhjet e jashtëzakonshme, për shkak se në draftin e parë të sjellur nga Juergen Schatz ka qenë afati prej më së paku dy ditë më herët të bëhet ftesa për mbledhje të jashtëzakonshme, ndërsa në draftin përfundimtar që është para anëtarëve të komisionit shënon që mbledhjet e jashtëzakonshme caktohen në afatin më të hershëm të mundshëm. Nuk u pajtua me këtë, për shkak se edhe mundësitë objektive dhe procedurat nuk lejojnë që të mbahet një mbledhje e jashtëzakonshme dhe të mblidhen të gjithë anëtarët e komisionit brenda një dite. Propozoi që të mbetet varianti i draftit të parë ose të bëhet më së voni një ditë.

Latif Gashi, arsyetoi që versioni përfundimtar është më i arsyeshëm duke marrë parasysh që Kosova është në situatë kur duhet të nxjerrë ligje për një periudhë më të shkurtë dhe paraqitet nevoja që të mbahet ndonjë mbledhje urgjente.

Kryetarja, shprehu vërejtje për renditjen jo të mirë të fjalëve ku mund të jetë për shkak të përkthimit, mirëpo mbledhjet e jashtëzakonshme nuk pyesin dhe caktimi i afatit nuk e bën atëherë atë mbledhje të jashtëzakonshme.

Hykmete Bajrami, propozoi që me një fusnotë të caktohet se cilat raste e bëjnë një mbledhje të jashtëzakonshme ose që në mbledhjen e fundit të njoftohen anëtarët e komisionit që ekziston

mundësia që të thirren në një mbledhje të jashtëzakonshme. Gjithashtu shprehu vërejtje për mungesën e mediave gjatë mbledhjeve të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe kërkoi sqarime për këtë çështje se si është parashikuar me rregulloren e komisionit.

Kryetarja, sqaroi që nuk është obligim i asnjë kryetari të komisionit që t’u bëj ftesë mediave, mirëpo datat e mbajtjes së mbledhjeve të komisionit publikohen çdo herë në web faqen e Kuvendit. Në draft-rregulloren e punës së komisionit shënon që mediat të cilat dëshirojnë të marrin pjesë në mbledhjen e komisionit duhet të lajmërohen një ditë më herët te stafi i administratës së komisionit dhe të bëjnë lajmërimin me shkrim paraprakisht.

Komisioni me shtatë vota për (Safete Hadërgjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj dhe Xhevdet Neziraj), një kundër (Albana Fetoshi) dhe asnjë abstenim vendosi që pika 3 e nenit 7 të mbetet e njëjtë.

Kryetarja, propozoi që neni 15 pika 5 të riformulohet si në vijim: “Në pajtim me nenin 57.3 të Rregullores së Punës së Kuvendit, propozimet për amendamente në projektligj mund të bëhen në afatin prej dy javësh pune nga data e miratimit të projektligjit në parim”.

Komisioni përkrahu njëzëri riformulimin e pikës 5 të nenit 15.

7. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje tjetër për të diskutuar.

Mbledhja përfundoi në orën 15:00

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete Hadërgjonaj